



316
2.3.2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSPEKTORATI SHTETËROR TEKNIK DHE INDUSTRIAL

Nr. 5393 prot.

Tiranë, më 30.8. 2021

Lënda: Kërkesë për trajtimin e kërkesave ligjore në Rregulloren për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes.

Z.PETRIT AHMETI

Kryetar,

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bulevardi Bajram Curri, Rruga Viktor Eftimiu, nr.1023,

Tiranë

Z. Ahmeti !

Këshilli i Ministrave ka miratuar rregullat teknike në lidhje me pajisjet, instalimet, linjat elektrike, dhe konkretisht ;

- VKM Nr.245, dt. 30.03.2016 “Për miratimin e rregullit teknik për kërkesat teknike në instalimin dhe kontrollin e dispozitivit diferencial, vendosur në pajisjet, impjantet dhe instalimet elektrike” dhe përcaktimin e listes se standarteve te harmonizuara.
- VKM Nr.482, dt.17.06.2020 “Për miratimin e rregullës teknike për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së linjave elektrike me tension të lartë mbi 1 KV”,
- VKM Nr.483, dt.17.06.2020 “Për miratimin e rregullit teknik për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së instalimeve elektrike të tensionit të lartë mbi 1 KV”.

Këto rregulla teknike kanë marrë fuqi ligjore të detyrueshme për zbatim nga ana e operatorëve ekonomikë dhe përdoruesve që veprojnë në treg.

Në veçanti, pa përjashtuar kërkesat teknike dhe standartet që kanë vendosur të detyrueshme për zbatim, kërkohet që përpara vënies në shfrytëzim të instalimit / linjës / impjantit elektrik, të cilat nuk janë në pronësi të kompanive të transmetimit dhe / ose shpërndarjes, pronari / personi përgjegjës, duhet ta rregjistrojë atë pranë inspektoratit shtetëror përgjegjës (aktualisht I.SH.T.I), kërkesë kjo dhe e Ligjit nr.10489 dt. 15.12.2011 “Për Tregëtimin dhe Mbikqyrjen e Produkteve jo Ushqimore” neni 16 pika ‘2’ dhe pika ‘3’.

Rregjistrimi kryhet mbi bazën e kërkesës që bëjnë subjektet që kanë detyrimin për të bërë rregjistrimin. Mos rregjistrimi nga ana e subjektit përbën shkelje të dënueshme me masë administrative nga ligji, dhe, çon në shmangien e detyrimeve ligjore të sigurisë elektrike.

Sa më sipër, për zbatimin të këtij detyrimi ligjor, në vijim të implementimit të mëtejshëm të rregullave teknike për rritjen e sigurisë elektrike, kërkojmë nga ana e juaj ;

1. Të trajtohet nga ana juaj në Rregulloren e Lidhjeve të Reja në Sistemin e Shpërndarjes, detyrimi i subjektit për të bërë rregjistrimin si kusht ligjor, përpara vënies në shfrytëzim (dhënies tension) vërtetuar me dokumentin përkatës të lëshuar nga ana e I.SH.T.I.
2. Në Rregulloren e Lidhjeve të Reja në Sistemin e Shpërndarjes, pjesa II, “Dokumentacioni i kërkuar për aplikimin e një lidhje te re”, Për Lidhje të Reja në TU, pika, 2.1 Fuqia e instaluar 0-20 kW, **të kërkohet projekti elektrik si detyrim i Ligjit 8734 dt.01.02.2001 i ndryshuar neni 7 pika 3 ;** “ Çdo instalim elektrik duhet të ketë projektin përkatës. Çdo montim ose rikonstruksion në instalimet elektrike bëhet me projekt”.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin,

KRYEINSPEKTOR

Fiqiret KOVAÇI

